

VENDIM
Nr. 688 , datë 14.11.2018

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE TE FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË OBJEKTIT ME
EMËRTIM “OBORR I QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE ‘NËNË TEREZA’,
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” , të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të një pjese të oborrit të brendshëm të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, me sipërfaqe 10 457 m²,

zona kadastrale nr. 8130, në njësinë administrative nr. 3, Bashkia Tiranë, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim shfrytëzimin për parkim, përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor të shërbimeve publike, që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose ta japë në përdorim të tre të tretët që nuk janë në varësi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

3. Nga aktiviteti që do të zhvillojë Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për përmirësimin e infrastrukturës së jashtme urbane dhe pritëse, si dhe menaxhimin cilësor i shërbimeve publike, që do të zhvillohen në këtë sipërfaqe, do të përfitojë 55% të të ardhurave, ndërsa Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, do të përfitojë 45% të të ardhurave.

4. Vlera prej 45% e të ardhurave, si pjesë takuese e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, do të ndahet sipas modalitetit të mëposhtëm:

a) 3% do të kalojë në llogarinë e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, me destinacion edukimin në vazhdim të burimeve njerëzore të kësaj qendre;

b) 42% do të investohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, me kërkesë të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe pas miratimit paraprak të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në infrastrukturë, për përmirësimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në përmbushje të objektivave dhe të misionit të saj.

5. Marrëdhëniet ndërmjet Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit do të rregullohen me marrëveshje të përbashkët.

6. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Senida Mesi

Planvendosja e pasurive që kalojnë nga MSHMS te Fondi Shqiptar
i Zhvillimit për llogari të QSUT, Tiranë.

Sipërfaqja totale për hapësirat e parkimit në QSUT: 10457m²

TR-J-14

Legjenda:

-  Kufi rrethues i QSUT
-  Objekt Spitalor
-  Parkimet

